



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 496/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 26.07.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-21517-05-10-2019, me objekt Loti II “*Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatin (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent*”, me fond limit 15.085.710,47 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: “Montal” sh.p.k.
Rruga “Dervish Hima”, 3 Kullat, K3, Shk.1, Ap.9/2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Subjekte të interesuar: “Fedos” sh.p.k.
Rruga “Isa Boletini”, Pallati “Planet X”, Kati I, Ap.9, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-21517-05-10-2019, me objekt Loti II “Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”, me

fond limit 15.085.710,47 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 05.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | |
|----|------------------|------------------------------|
| 1. | “Fedos” sh.p.k. | 14.695.725 lekë, kualifikuar |
| 2. | “Montal” sh.p.k. | 15.064.630 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 20.06.2019 operatori ekonomik “Montal” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 27.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]

Pika Nr.1

Objekti i kësaj procedure prokurimi eshte: “Blerje materiale mjekesore për shërbimin e Laboratorit Imunologjik ne QSUT për vitin 2019-2020” e ndare ne Lote. Loti II “Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatin (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”.

Pra qëllimi I kësaj procedure është të prokuroje Materiale Mjekesore (Reagente) për pajisjet në pronësi të autoritetit kontraktor QSUT “Nënë Tereza” LAZER IMUNONEFELOMETRI Model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY Model EPICS – XL të prodhuesit Beckman Coulter. Nga informacioni i tregut që ne disponojme, operatori ekonomik Fedos sh.p. bashkepunon me kompanine Becton Dickinson e cila nuk ofron reagente që përputhen me funksionimin e pajisjeve të instaluar ne Laboratorin Imunologjik të QSU “Nene Tereza” të cilave ju referohet kjo procedure prokurimi.

Ne kundërshtim me Nenin 53, Pika 3 te LPP, Autoriteti kontraktor ka vlerësuar oferten e OE FEDOS shpk te vlefshme nderkohe qe reagentet e prodhuesit Becton Dickinson te ofruar nga FEDOS shpk nuk funksionojnë me pajisjet e percaktuara ne objektin e kesaj procedure per te cilat eshte kerkuar furnizimi me material.

Nga informacioni qe disponojme, FEDOS shpk, duke mos permbushur kerkesen e perpuethshmerise se reagenteve te ofruar me pajisjet objekt i kesaj procedure ka ofruar pajisje ne menyre qe te funksionojne reagentet e prodhuar nga Becton Dickinson. Nderkohe, ne Dokumentat Standarde te Tenderit nuk permendet qe kerkohen apo qe mund te ofrohen pajisje alternative per te realizuar matjen e parametrave te kerkuar, por kerkohen te ofrohen reagent të cilet duhet të funksionojne me aparataturat ekszistuese të spitalit sipas specifikimeve te percaktuara ne Shtojcen Nr.10 dhe ne Shtojcen Nr.12.

OE FEDOS shpk ka ofruar mallrat e kerkuara nga AK me kushtin e dhenies ne perdorim prej tyre te pajisjes/pajisjeve te ndryshme nga prodhuesi Becton Dickinson. Njoftimi i Kontrates dhe Dokumentat e Tenderit (DT), qe hartohen bazuar ne Urdherin e Prokurimit perkates, kane percakuar qe objekti i kontrates eshte "Blerje materiale mjekesore per sherbimin e Laboratorit Immunologjik ne QSUT per viti 2019-2020" e ndare ne Lote: Loti 2: Reagente per LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE te pershtatshem per aparatit Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagente per FLOW CYTOMETRY te pershtatshem per aparatit (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent". Pra, na rezulton, se dhenia ne perdorim e pajisjes/pajisjeve, eshte nje element qe nuk eshte kerkuar nga AK ne Dokumentat e Tenderit, cka del jashte objektit te percaktuar nga vete AK ne Urdherin e Prokurimit dhe nga vete DST ku percaktohet si meposhte: Seksioni 2. Objekti i kontrates

2.1 Numri i references se procedures/lotit: REF-21512-05-10-2019

Lot 1: REF-21515-05-10-2019

Lot 2: REF-21517-05-10-2019

2.2 Lloji i "Kontratave Publike per Mallra"

Blerje Qira Leasing Blerje me keste Nje kombinim I tyre

X

Pergjegjesite qe u kerkohen Operatoreve ekonomike ne Dokumentat e Tenderit jane ato qe lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne Laboratorin Immunologjik sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve te kerkuara prej AK na DST. KVO nuk mund te pranoje ofrimin e pajisjeve ne perdorim nga OE FEDOS shpk, si kusht per furnizimin e mallrave te kerkuar nga AK pasi kjo eshte nje pergjegjesie papercaktuar ne dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka te tille ka shkelur nenin 51/2 te LPP qe percakton: "Nje ofertuesi si kusht per shpalljen fitues, nuk duhet ti kerkohet qe te ndermarre pergjegjesi te papercaktuara ne dokumentat e tenderit, te ndryshoje vleren e ofertes se tij ose te modifikojte ne cfaredolloj menyre oferten. Nese AK do te kishte parashikuar edhe pranimin e dhenies ne perdorim te aparatures, Dokumentat e Tenderit do te ishin ndertuar si ne procedure me nr. REF-99599-12-17-2018, me objekt "Furnizim me Materiale Mjekesore ne Sherbimin e Hemodializes ne QSUT per vitin 2019-2021", ku jo vetem eshte percaktuar ne menyre specifike kerkesa per dhenien ne perdorim te aparaturave por jane percaktuar edhe kerkesat dhe specifikimet teknik ne lidhje me to. Autoriteti kontraktor ka percaktuar si objekt prokurimi thjesht blerjen e reagenteve, si edhe ka percaktuar ne dokumentat e tenderit vetem pajisjet qe ajo ka aktualisht ne perdorim dhe per te cilat duhet te blihen reagent, pra ne asnje moment nuk ka percaktuar ne dokumentat e tenderit se, pajisjet qe ka aktualisht ne perdorim nuk do te perdoren me dhe qe te gjithe operoret ekonomike pjesemarmes duhet te ofrojne reagentet se bashku me pajisjet e tyre qe pershtaten me keto reagent.

Pika Nr.2

Ne Dokumentat e tenderit, pika 2. 14 te DST, nga AK eshte percaktuar qarte qe nuk do te pranohen variantet

2.14 Do te pranohen variante

Po Jo X

OE FEDOS shpk duke ofruar mallrat e kerkuara te shoqeruara me kushtin e dhenies ne perdorim te pajisjeve te ndryshme nga ato qe disponon AK, te pakerkuara nga AK, gjendet ne kushtet e ofertes alternative e cila sipas kushteve te Dokumentave te Tenderit nuk lejohet. Neni 54 i LPP

percakton qe ofertat alternative nuk lejohen, nese nuk jane autorizuar nga AK sic eshte rasti konkret. Nga ana tjeter, eshte vete autoriteti kontraktor ai qe ka percaktuar ne dokumentat e tenderit qe nuk do te pranohen variante, kur nderkohe kualifikon oferten e nje operatori ekonomik i cili oferton me produkte te pajisjeve te tjera ne kundershtrim te specifikimeve teknik te hartuara dhe percaktuara ne dokumentat e tenderit, madje duke lejuar edhe ofertimin e pajisjeve per keto reagente, nderkohe qe objekti i prokurimit eshte vetem blerja e reagenteve. Autoriteti kontraktor nuk mund te lejoje marrjen ne perdorim te nje pajisje tjeter nga ajo qe vete autoriteti kontraktor disponon, ne kundershtrim me percaktimet e tenderit ku ka percaktuar vetem blerjen e mallit, e per me teper qe nje gje e tille nuk eshte percaktuar dhe nuk eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit. Pranimi i marrjes ne perdorim i pajisjeve, referuar si udhezimeve te Ministrise se Shendetesise ashtu edhe legjislacionit per prokurimin publik, duhet te behet nepermjet procedurave te prokurimit sipas percaktimeve te bera ne kete legjislacion. Kualifikimi i operatori ekonomik FEDOS shpk, oferta e te cilit perfshin ofrimin e reagenteve dhe aksesoreve se bashku me pajisjet per keto reagente, ne kushtet kur objekti i prokurimit eshte blerje malla, vjen ne kundershtrim me percaktimet e bera ne dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe shkakton diskriminim dhe konkurrence te pandershme per operatoret e tjere ekonomike pjesemarres.

Për më teper, percaktimi i termit "ose ekuivalent" ne Specifikimet Teknike i referohet mallrave te kerkuara ne rastet kur ato mund te ofrohen nga prodhues te ndryshem nga prodhuesit e paisjeve, por gjithmone me kusht qe produktet e tyre (i) te perputhen me kerkesat e autoritetit kontraktor, (ii) te permbushin te gjitha specifikimet teknike dhe (iii) te jene funksionale per nevojat e AK. Ne rastin konkret produktet e ofruara nga OE FEDOS shpk nuk i permbushin keto kushte, sic argumentohet edhe ne piken vijuese Nr.3.

Pika Nr.3

OE FEDOS shpk nuk permbush Specifikimet Teknike

Sic u sqarua me siper, OE FEDOS shpk nuk mundet ti pranohet oferta per reagentet e kerkuar nga AK, me kushtin e dhenies ne perdorim te nje pajisjeje qe sipas ketij OE mund te jete "ekuivalente" me pajisjet LAZER IMUNONEFELOMETER IMAGE dhe FLOW CYTOMETER EPICS-XL. Edhe ne rast te vleresimit te "ekuivalences" se platformes/aparaturave te ofruara nga OE FEDOS shpk, perkundrejt pajisjeve IMUNONEFELOMETER IMAGE dhe FLOW CYTOMETER EPICS-XL, serish specifikimet teknike nuk permbushen sepse:

Ne Lotin 2 te tenderit jane kerkuar 2 grupe reagentesh dhe konkretisht:

- REAGENTE PER PROTEINAT IMUNOLOGJIKE SERIKE ME LAZER-IMUNONEFELOMETER (artikujt nr. 1-21), ne specifikimet teknike te se cilave (shih kolonen "Metoda") kerkohet qe metoda te jete NEFELOMETRIKE*
- REAGENTE PER IMUNOFENOTIPIZIM LEUKOCITAR ME FLOW CYTOMETRY (artikujt nr.22-70), ne specifikimet teknik te se cilave (shih kolonen "Metoda") kerkohet qe metoda te jete "FLOW CYTOMETER".*

Te gjitha artikujt e grupit te pare qe ne titull jane specifikuar qarte si "Reagente per proteinat serologjike me LAZERIMUNONEFELOMETER". Per me teper, per te gjitha keto reagente eshte specifikuar fare qarte qe metoda e percaktimit të tyre duhet te jete metoda "NEFELOMETRIKE". OE FEDOS shpk nuk permbush specifikimet teknik te kerkuara ne DST per asnje prej artikujve NR 1-21 madje nuk ofron ndonje aparature te tipit Laserimunonefelometer qe te mundesoje perpunimin e reagenteve per percaktimet me metoden nefelometrike. Aresyeja eshte se firma

Becton Dickinson, aparaturat e te cilit FEDOS ofron ne perdorim, nuk prodhon dhe furnizon aparatura te tipit "Laserimunonefelometer" dhe as reagente qe punojne me metoden nefelometrike. OE FEDOS shpk ofron ne perdorim nje analizator te tipit Flow Cytometer sebashku me nje aparature ndihmese per pergatitjen e kampioneve per kete Flow Cytometer, nje kombinim i cili mundeson vetem percaktim me metoden "flow cytometrike", por jo me metoden "nefelometrike. Ne aspektin teknik, nje oferte e tille, ne rastin me te mire, mund te permbushet vetem specifikimet e reagenteve te grupit te dyte qe kerkohen te punojne me analizator dhe metode "FLOW CYTOMETRY", por nuk mundet asesi te permbushin specifikimet thelbesore per reagentet nr. 1-21 qe kerkohen te perpunohen me LAZERIMUNONEFELOMETER dhe metode NEFELOMETRIKE. Vejme ne dukje gjithashtu, se sherbimi i imunologjise ka kerkuar prej vitesh sikurse edhe ne kete tender vleresimin krahasimor te disa parametrave te rendesishem imunologjike sikurse "Kappa Light Chain" dhe "Lambda Light Chain" njeheresh nepermjet dy metodave: metodet "nefelometrike" (perkatesisht reagentet nr.8, 9) dhe metodet "flow cytometrike" (perkatesisht reagentet nr 29, 30). Oferta e OE FEDOS shpk nuk mund ta realizoje kete gje sepse ajo nuk mundeson metoden "nefelometrike". Rrjedhimisht oferta e OE FEDOS eshte teresisht jashte specifikimeve teknik thelbesore per te gjitha grupin e artikujve 1-21.

Gjithashtu, oferta e OE FEDOS, nuk permbush nomenklaturen e kerkuar te nje sere artikujsh (nr. 11, 12, 13, 14, 15, 16), paketimet, etj

Ne konkluzion, duke u bazuar ne te gjitha argumentat e mesiperme, kerkojme qe oferta e Operatorit Ekonomik FEDOS shpk te refuzohet.

II.5. Me shkresën nr. 2411/3 prot., datë 03.07.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...]

Ne lidhje me kerkesat e subjektit ankues, Anetaret e Komisionit te Shqyrtimit te Ankeses (KSHA), referuar dhe specializimeve perkatese, argumentojne si me poshte vijon:

Vleresimi dhe gjykimi i KSHA:

Per sa i perket pretendimeve te OE ankimes, KSHA ne zbatim te parashikimeve te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, si dhe VKM 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, KSHA vlereson se:

Ne lidhje me piken 1 dhe piken 2 me siper:

Se pari, KSHA vlereson, se nga verifikimi i dokumentacionit tekniko- ligjor te vene ne dispozicion, KVO ka vleresuar OE ofertues, konkretisht edhe per OE Fedos shpk, mbi bazen e mallrave te ofertuar (materiale mjekesore- reagente), referuar Formularit te Ofertes sipas Shtojces I si dhe te gjitha dokumentacionit tekniko-ligjor te administruar ne SPE, ne krahasim me kerkesat e bera ne DST nga AK, dhe ne rastin e OE Fedos, KVO nuk ka vleresuar oferten ekonomike duke u bazuar ne ofrimin e aparaturave falas, por vleresimi i ofertes ekonomike rezulton te jete bere mbi bazen e permbushjeve te kriterave te kerkuara ne DST ne lidhje me specifikimet teknike te mallrave qe kerkohen te prokurohen etj.

Per sa i perket situates qe OE ankues shtron, vlen te sqarohet se nisur qe nga titulli i procedures se prokurimit, qe eshte: Blerje materiale mjekesore per sherbimin e Laboratorit munologjik ne QSUT per vitin 2019-2020 " e ndare ne Lote si me poshte: Loti 1, Reagente per munologjine e

Pergjithshme dhe Pajtueshmerine Indore (Transplante) dhe Lot 2, Reagente per LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE te pershtatshem per aparatit Beckman Coulter e ekuivalent dhe reagente per FLOW CYTOMETRY te pershtatshem per aparatit (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent, rezulton se AK nepemmet kontrates publike te shpallur ne SPE, te ndare ne dy lote, synon blerjen e materialeve mjekesore (reagente), fakt ky qe edhe vete OE ankues e citon si vijon: ...qellim i kesaj procedure eshte te prokuroje material mjekesore (reagente) per pajisjet ne pronesi te AK...[...]...LAZER IMUNONEFELOMETRI model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY model EPICS-XL.

Per sa i perket ceshtjes ne teresi qe shtron OE ankues ne pike 1 dhe 2, ne lidhje me aparatet ne pronesi te AK, rezulton se titulli i kontrates ne teresi per Lotin 2 eshte: Reagente per LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE te pershtatshem ner aparatit Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagente per FLOW CYTOMETRY te pershtatshem per aparatit (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent”, dhe jo sic citohet nga OE ne ankim, ku citohet: REAGENTE per LAZER IMUNONEFELOMETRI model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY model EPICS-XL. Pra se pari vlen te theksojme se objekti i prokurimit eshte blerje reagente (materiale mjekesore), dhe jo materiale mjekesore posacerisht per x apo y aparat, per kete arsye jo me kot AK referon ne titullin e kontrates se shpallur: te pershtatshem per aparatit Beckman Coulter ose ekuivalent dhe te pershtatshem per aparatit (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent. Ne kete konstekst, qe ne kete pike, del qarte se AK kerkon te prokuroje mall (materiale mjekesore-reagente), i cili duhet se pari te plotesoje specifikimet teknike te pasqyruara ne DST, dhe i cili te jete i pershtatshem per aparatit qe AK disponon ose te jete i pershtatshem per nje aparat tjeter ekuivalent dhe te cilin nese AK e disponon apo jo nuk eshte objekt vleresimi apo ankimi nga operatoret ekonomik ofertues. Me tej, referuar dispozitave ligjore ne fuqi te parashikuara Legjislacionin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, eshte vete AK qe percakton mallrat me te cilet synon te furnizohet nepemjet prokurimit, specifikimet teknik qe duhet te permbushin keto mallra, si dhe harton kriteret e nevojshme qe nje ofertues i mundshem duhet te plotesoje qe te kualifikohet si ofertues ne proceduren e prokurimit te cilen vete AK e shpall sipas procedurave ligjore ne fuqi, nepermjet Dokumenteve Standarde te Tenderit te hartuara dhe miratuara nga APP sipas parashikimit te nenit 13, germa ç) ku citohet se: APP.. harton dokumentet standarde te tenderit, qe do te perdoren ne procedurat e prokurimit, sipas rregullave te prokurimit public; Referuar Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, ne nenin 23 (Specifikimet teknik) Legjislatori sanksionon se: 1.Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristika e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. [...] dhe 2 .

Specifikimet teknike duhet te mundesoje trajtim te njejte per te giithe kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin public. Kete qendrim ne lidhje me perdorimin e termit ekuivalent, mban edhe vete Agjencia e Prokurimit Publik ne Rekomandimin Nr 3341 / I prot , date 20 . 03 . 2018 " Rekomandim mbi hartimin e kriterave per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik", drejtuar Autoriteteve Kontraktore, dhe ne kete kuader, si dhe ne zbatim te frymes se legjislacionit qe rregullon fushen e prokurimit publik jemi para parimit Argumentum ab auctoritate fortissimum est in lege - pra para parimit se nje argument I shkruar nga autoriteti me i larte qe eshte APP, ka fuqine e ligjit per te

gjithë aktoret si në cilesinë e AK ashtu dhe në cilesinë e OE. Dhe për atë kohë se në kontratën e shpallur kerkohen materiale mjekesore të pershtatshme për një aparat X ose ekuivalent, KSHA vlerëson se AK ka çdo të drejtë të mundshme të kualifikojë një operator ekonomik ofertues, në rastin kur mallrat e ofruar plotësojnë specifikimet teknik të kerkuara në DST, si dhe OE ofertues përmbush të gjitha kriteret kualifikuese të hartuara sipas nenit 46 të LPP të cilat përcaktohen nga AK në DST dhe që AK i vlerëson sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 4, 5/c, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr 914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Së dyti, e gjitha gama e ankimit është e ndertuar dhe referohet vetëm mbi bazën e informacionit që OE Ankues "Montal" Shpk, pretendon se disponon, por në asnjë rast, ankimit nuk i bashkelidhet dokumentacion teknik i ligjor që të vertetojë ato që ankuesi referon, apo të ndihmojë AK në thellimin e hetimit administrativ për të dhënë një përgjigje bazuar në parimin stricti iuris, pasi referuar dokumentacionit të venë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit, rezultojnë se mallrat e ofruar nga OE Fedos Shpk, i përmbushin specifikimet teknik të kerkuara nga AK. Referuar legjislacionit në fuqi, qoftë në këtë rast, si dhe në rastin që OE Montal Shpk, apo çdo OE tjetër ushtron pretendime për një operator tjetër ekonomik, në ankesën e paraqitur, ka detyrimin ligjor për të argumentuar pretendimet e ngritura, në kuptimin klasik të barres së provës (kur barra e provës i bie kerkuesit) dhe në rastin objekt shqyrtimi, OE Montal Shpk, në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe me pas provuar me dokumente shtese (por vetëm referuar dhe mbi bazën e pretendimeve) faktin e mosplotësimit të specifikimeve teknik nga OE Fedos Shpk. Këtë argumentim KSHA e mbështet në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 12 ku citohet se: "Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pjetendimin e saj", neni 1 [...]; Neni 47 [...]; Neni 78/1 [...] dhe neni 82 pika 1 [...].

Se treti, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, KSHA vlerëson se në asnjë moment ofrimi i aparateve falas nga OE ofertues, nuk parashikohet si kusht në DST. Nga verifikimi i procesverbalit të mbajtur nga KVO dhe raportit të gjeneruar nga SPE, gjithashtu rezultojnë se në asnjë moment ofrimi i aparateve falas nuk ka shërbyer si kusht për KVO që të vlerësojë një ofertë si të vlefshme apo jo, pasi vlerësimi i vlefshmerisë së ofertes nga KVO është bërë duke u bazuar në përmbushjen e specifikimeve teknik të mallrave të ofertuar si dhe në përmbushjen e kriterëve kualifikuesë të pasqyruara në DST. Pra rezultojnë se KVO në vlerësim është bazuar në faktin se të dy OE ofertues në këtë procedurë prokurimi, plotësojnë kriteret e kualifikimit të kerkuara nga AK në DST, dhe për këtë arsye KVO ka vlerësuar dhe me pas kualifikuar të dy OE ofertues, duke bërë me pas dhe renditjen përkatëse bazuar në kriterin çmimi me i ulët sipas përcaktimeve të DST, në të njëjtën kohë duke mosdiskriminuar asnjë OE ofertues.

Për sa i përket pikës 3 me siper, referuar ankesës së OE Montal Shpk, KSHA vlerëson se: Materialet mjekesore të ofruar nga OE Fedos Shpk, përmbushin specifikimet teknik të kerkuara në DST, kjo jo vetëm nga dokumentacioni i administruar në SPE, por edhe nga dokumentacioni tekniko-ligjor shkësor që administrohet nga AK, pasi referuar korrespondencës së KVO në zbatim të procedurave ligjore, rezultojnë se jo vetëm që OE ofertues përmbush specifikimet teknike të kerkuara në DST nga AK, por gjithashtu rezultojnë se malli i ofruar rezultojnë me përfitime qoftë në cilësi, qoftë në përfitime ekonomike për AK, duke përmbushur në të njëjtën kohë kushtet ligjore për të zbatuar kontratën e shpallur. Kjo referuar edhe korrespondencës me Sherbimin e

Imunologjise dhe Pajtueshmerise Indore prana AK QSU "Nene Tereza", i cili ben me dije Komisionin e Vleresimit te Ofertave per pyetjet e shtruara dhe pergjigjet sa me poshte:

Pyetjet e KVO:

- 1. Lutem te na sqaroni dhe informoni mbi pajisjet qe paragiten nga ky ofertues, ne se Sherbimi I Laboratorit Imunologjik eshte i njohur me keto pajisje, eshte ne gjendje te perdore teknologjine e ofruar bazuar ne metodat e tuaja te ofrimit te sherbimit.*
- 2. Gjithashtu na informoni nese ofrimi nga ky OE i ketyre pajisjeve ka impakt negativ apo pozitiv prane Sherbimit krahasuar me pajisjet ekzistuese qe ndodhen prane Sherbimit dhe nese ka ndikim ne rritjen e performances prane Sherbimit etj.*
- 3. Per sa i perket mallit te ofertuar, lutemi te na sqaroni nese perben problematike apo pengese per sherbimin, paketimi i produkteve duke u ndodhur para faktit qe sasia ne total nuk ndryshon per mallin e kerkuar per Lot I dhe Lot 2 sipas DST bashkelidhur.*

Pergjigja e Sherbimeve prana AK:

Teknologjia e Citometrit me fluks BD FACS Canto II te kompanise Beckton-Dickinson:

BD FACS Canto II eshte nje gjenerate e re ne fushen e citometrise me fluks. Kjo pajisje eshte e projektuar per perdorim si ne labororet klinike ashtu dhe hulumtues. Eshte nder teknologjite me te perdorura ne Europe dhe me gjere. Kjo teknologji ka performace te larte, sakesi dhe cilesi ne dhenien e rezultateve. FACS Canto II ka disa perparesi krahasuar me EPICS-XL te Beckman Coulter qe eshte ne perdorim aktualisht:

- Eshte teknologji 15 vite me e re*
- Eshte e pajisur me tre lazera krahasuar me ate qe disponojme aktualisht qe ka nje lazer.*
- Detekton 8 ngjyra krahas 4 ngjyra qe detekton ajo aktuale.*
- Softëare eshte shume me i avancuar pasi jep shume te dhena njekohesisht mbi popullatat qelizore, ruan per nje kohe te gjate te dhenat, i perpunon ato dhe i printon njekohesisht. Nderkohe që EPICS-XL aktual që disponojme ka mangesi, si ne ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave dhe printimin automatik te tyre.*
- Marrja e mostrave ne menyre automatike ben qe te rritet shpejtesia e perfitimit te te dhenave.*

Imunonefelometri SPA PLUS te kompanise angleze Binding Site:

Ky autoanalizator eshte prodhim i kompanise angleze Binding Site, e njohur ne kete fushe. Eshte nje autoanalizator qe eshte projektuar enkas per matjen e proteinave serike. Ka nje sistem plotesisht automatik qe ofron rezultate te cilesise se larte. Rezultati i pare del ne 15 min dhe ato pasardhese pas cdo 30 sek. Realizon 240 ekzaminime per nje ore. Siguron perdorim optimal te reagentit pasi jane ne paketime me numer me te vogel testesh. Eshte teknologji me e avancuar pasi eshte 15 vjet me e re si gjenerate pajisjesh te ketij lloji.

Dhe në këte kuader, KSHA vlereson se KVO ka vleresuar drejtë dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi persa I perket kualifikimit te OE Fedos sh.p.k., dhe per pasoje pretendimi I ngritur nga OE Montal shpk, nuk qendron.

Ne kete kuader, per sa eshte argumentuar me siper, si dhe ne kuader te frymes se transparences te cilen legjislatori e synon nepermjet legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, KSHA ne respektim te detyrimeve qe burojne nga dispozitat e ligjit nr. 9643 dt 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar si dhe VKM nr 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publike ndryshuar, ka arritur ne, Konkluzionin:

Te mos pranoje pretendimet e ngritura nga OE Montal SHPK, ne ankesen e administruar prane AK QSU "Nene Tereza" me nr. 2411 prot., date 27.06.2019, si e pabazuar ne ligj dhe prova.

II.6. Në datën 12.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k.. Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:
[...] *Me date 03.07.2019 jemi njoftuar ne menyre elektronike nepermjet emailit per pergjigjen negative nda ankeses tone nga ana e KSHA-se QSUT “Nene Tereza” dhe ne menyre shkresore me date 06.07.2019.*

[...]

Lidhur me pergjigjen e KSHA-se ndaj pikes 1 dhe 2 te ankeses tone dhe argumentimi nga Montal: Argumentimi nga MONTAL:

Ne DST nuk eshte shprehur askund qe reagentet te jene te pershtatshem per nje aparat tjetër ekuivalent, sepse nese ky aparat tjetër ekuivalent do te ishte ekzistues, sikurse jane aparatet e ekzistues ne QSUT model IMAGE dhe EPICS-XL nga Beckman Coulter, ato do te ishin referuar me modelet konkrete te tyre, te cilat faktikisht nuk ekzistojne ne QSUT. Ndersa nese Ak do te kishte planifikuar qe keto aparate "ekuivalente" do te furnizoheshin nga operatore ekonomike ajo do te kishte detyrimin per ta shprehur kete ne DST, madje duke qene te detyruar sipas Ligjit te Pajisjeve Mjekesore per te kerkuar edhe kriteret dhe specifikime shtese per pajisjet mjekesore qe do te ofroheshin, sikurse jane kerkesa teknik certifikata cilesie CE, informacione apo kushtezime qe keto aparate te jene te reja, te perdorura apo te rikondicionuara, nese keto aparate do te jepen ne perdorim apo do te mbeten ne perfundim te kontrates ne pronesi te AK etj, etj. Asgje e tille nuk eshte shprehur ne DST.

Eshte e qarte pra qe fjala "ekuivalent" ne titullin e tenderit dhe specifikimet ne DST nuk ka dhe nuk mund te kete kuptim tjetër pervecse kerkeses se qarte qe reagentet e kerkuar mund te ofrohen io detyrimisht si reagente origjinale nga prodhuesi i pajisieve Beckman Coulter, por edhe nga prodhues te tjere te cilet mund te furnizojne reagente ekuivalente perkundrejt atyre origjinale te markes Beckman Coulter, por me kushtin e qarte qe te jene te pershtatshem per aparatet IMAGE dhe EPICS-XL.

[...]

Eshte nje fakt i qarte dhe i pamohuar nga askush qe reagentet e ofruar nga FEDOS nuk jane te pershtatshem per aparatet ekzistuese IMAGE dhe EPICS XL. Perdorimi i tyre mundesohet vetem me kushtin qe FEDOS te ofroje falas ose ne perdorim te sherbimit ne QSUT aparatet e konsideruara si "ekuivalente" dhe pikerisht:

- SPA PLUS te kompanise angleze Binding Site ne vend te aparatit ekzistues IMAGE nga Beckman Coulter.
- BD FACS Canto II te kompanie Beckton-Dickinson ne vend te EPICX XL nga Beckman Coulter.

Por, edhe sikur keto aparate te jene vertet ekuivalente ndaj aparateve ekzistuese te kerkuar (cka nuk eshte vertete dhe per kete lexoni piken 3 te ankeses sone) eshte e qarte qe KVO e ka kualifikuar oferten e FEDOS pikerisht mbi bazen e ketij kushti te pakerkuar ne DST, pra qe FEDOS te ofroje

keto aparate falas, ose ne perdorim. Ne te kundert reagentet e ofruar nga FEDOS nuk do te ishin te perdorshem dhe i gjithë shpenzimi per blerjen e tyre do te ishte dem i qarte ekonomik dhe nje pamundes absolute qe sherbimi i imunologjise te kryeje testimet e nevojshme per te cilat kerkohen te blihen keto reagente. Pra eshte i qarte qe "argumentimi" i mesiper nga KSHA nuk qendron. KVO ka shkelur hapur ligjin duke perdorur nje kusht te pakerkuar per kualifikimin e ofertes se FEDOS.

Ne "argumentimet e saj kontradiktore, KSHA i referohet pikerisht Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, ne nenin 23 (Specifikimet teknik) per te argumentuar krejt te kunderten e asaj qe kerkon ligji qe sanksionon pikerisht se: "1. Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithë kandidatëve e ofertuesve."

Neni i sipercituar eshte pikerisht njera nga referencat e qarta ligjore qe i kerkon AK dhe KVO te skualifikoje oferten e OE FEDOS, e cila eshte krejtesisht jashte objektit dhe specifikimeve te tenderit.

[...]

Argumentimi i mesiper eshte prezantuar nga KSHA ne lidhje me me piken 1 dhe 2 te ankese sone ndaj KVO, por ne fakt ajo ka te beje me piken tre te ankeses sone. KSHA ka paraqitur si argumentum pikerisht ate qe kvo dhe AK eshte perpjekur te na pamundesojë dhe pikerisht transparence e ofertes se OE FEDOS. Nga pergjigja e KSHA na jepen prova te mjaftueshme qe argumentojne ne menyre te pakundershtueshme faktin qe oferta e OE FEDOS nuk permbush specifikimet teknike te reagenteve te kerkuar (shihni argumentimin tone ne piken 3 te kesaj ankese). Pika 3

OE Fedos sh.p.k. nuk përmbush specifikimet teknike.

Aparati SPA PLUS dhe reagentet e ofruar nga Fedos nuk përmbushin kërkesen dhe specifikimet me thelbesore te tenderit per kete pajisje qe jane:

(Objekti i tenderit): Reagente per Lazer Imunonefelometri Image të pershtatshem per aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent. Aparati Lasernefelometer Image nga firma Beckman Coulter ka nje teknologji që mundeson analizat imunologjike serike me dy platforma metodologjike – teknologjike alternative, te cilat sikurse deshmohet nga manuali i perdorimit te tij (shih shtojcen rn.1), jane:

-Lasernefelometria, me metoden Nefelometrike, që realizohet me teknologjine Laser

-Turbidimetria, me metoden Turbidimetrike, që realizohet me teknologjinë diode LED.

Është një fakt i njohur që metoda nefelometrike me laser ka nje specificitet me te larte se ajo turbidimetrike dhe per kete arsye sherbimi i imunologjise ka kerkuar cdo vit, sikurse edhe ne kete tender, specifikisht reagente per laser nefelometer me metoden nefelometrike.

Në DST specifikohen dhe kerkohen te blihen:

-Reagente per proteinat imunologjike serike me Lazerimunonefelometer

-Metoda: Nefelometri

Fedos nuk ka ofruar reagente te pershtatshem per LaserNefelometrin IMAGE nga Beckman Coulter. Perkundrazi, Fedos ka ofruar reagente per aparatin SPA PLUS i cili nuk eshte aspak ekuivalent me LazerNefelometrin IMAGE. Analizatori SPA PLUS ka teknologji, platforme dhe

metodologji krejt te ndryshme nga sa kerkohet ne DST. Sikurse provohet fare lehte nga broshura/ katalogu i kesaj pajisje (shih shtojcat nr.2 dhe 3) rezulton se:

- Aparati SPA PLUS nuk eshte LazerNefelometer sikurse kerkohet ne DST, perkundrazi ai eshte Analizator Turbidimetrik.
- Platforma dhe metoda e SPA PLUS eshte Turbidimetria dhe jo LaserNefelometria sikurse kerkohet ne DST
- Aparati SPA PLUS nuk punon me teknologjine Lazer, por me teknologjinë llampe Haloge

Rrjedhimisht asnjë nga reagentet e ofruar nga FEDOS për aparatën SPA PLUS (artikujt 1 deri 21) nuk përmbushin specifikimet themelore teknike të kerkuara ne DST që jane:

-Reagente per proteinat imunologjike serike me Lazerimunonefelometer

-Metoda: Nefelometri

Specifikimet teknike realisht jane:

-Reagente per proteinat imunologjike serike me Turbidimetrike

-Metoda: Turbidimetrike

Nese ne DST do te kerkoheshin reagente të platformes dhe metodes turbidimetrke MONTAL do te ofronte reagente turbidimetrike per analizatorin IMAGE te Beckman Coulter, te cilet kane cmime shume me te ulta se ato te metodes nefelometrike me laser te kerkuar ne DST dhe te ofruar ne oferten tone. Ne nje rast te tille oferta jonë do te ishte financiarisht shume me e ulet se oferta e OE Fedos.

Aparati SPA PLUS jo vetem që nuk ofron platformes LaserNefelometrike te kerkuar ne tender, por ai edhe ne platformen Turbidimetrike nuk eshte ekuivalent me analizatorin IMAGE nga BeckmanCoulter, i cili platformen turbimetrike e mundeson nepermjet teknologjise Dse avancuar Diode Led, nderkohe qe platforma e SPA PLUS realizohet me teknologjine me inferiore me llampe Halogene (shih shtojcen nr.3 me specifikimet teknike te SPA PLUS). Per sa me siper kerkojme qe oferat e FEDOS te skualifikohet per shkak te mospermbushjes te specifikimeve te DST per Lotin 2. Ne konkluzion, duke u bazuar ne te gjithë argumentat e mesiper, kerkojme qe oferta e operatorit ekonomik Fedos shpk te refuzohet.

II.7. Në datën 22.07.2019, nëpërmjet shkresës me nr.2411/7 prot., datë 22.07.2019, me objekt: “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Montal” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. për arsye se: “Objekti i kësaj procedure prokurimi eshte: “Blerje

materiale mjekesore për shërbimin e Laboratorit Imunologjik në QSUT për vitin 2019-2020” e ndare në Lote. Loti II “Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”.

Pra qëllimi I kësaj procedure është të prokurojë Materiale Mjekesore (Reagente) për pajisjet në pronësi të autoritetit kontraktor QSUT “Nënë Tereza” LAZER IMUNONEFELOMETRI Model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY Model EPICS – XL të prodhuesit Beckman Coulter. Nga informacioni i tregut që në disponojmë, operatori ekonomik Fedos sh.p. bashkëpunon me kompaninë Becton Dickinson e cila nuk ofron reagente që përputhen me funksionimin e pajisjeve të instaluar në Laboratorin Imunologjik të QSU “Nënë Tereza” të cilave ju referohet kjo procedure prokurimi.

Në kundërshtim me Nenin 53, Pika 3 të LPP, Autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertën e OE FEDOS shpk të vlefshme nderkohe që reagentet e prodhuesit Becton Dickinson të ofruar nga FEDOS shpk nuk funksionojnë me pajisjet e përcaktuara në objektin e kësaj procedure për të cilat është kërkuar furnizimi me material.

Nga informacioni që disponojmë, FEDOS shpk, duke mos përmbushur kërkesën e përputhshmerisë së reagentëve të ofruar me pajisjet objekt i kësaj procedure ka ofruar pajisje në mënyrë që të funksionojnë reagentet e prodhuar nga Becton Dickinson. Nderkohe, në Dokumentat Standarde të Tenderit nuk përmendet që kerkohen apo që mund të ofrohen pajisje alternative për të realizuar matjen e parametrave të kërkuar, por kerkohen të ofrohen reagent të cilët duhet të funksionojnë me aparataturat ekzistuese të spitalit sipas specifikimeve të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 dhe në Shtojcën Nr.12.

OE FEDOS shpk ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK me kushtin e dhenies në përdorim prej tyre të pajisjes/pajisjeve të ndryshme nga prodhuesi Becton Dickinson. Njoftimi i Kontrates dhe Dokumentat e Tenderit (DT), që hartohen bazuar në Urdhërin e Prokurimit përkatës, kanë përcaktuar që objekti i kontrates është “Blerje materiale mjekesore për shërbimin e Laboratorit Imunologjik në QSUT për vitin 2019-2020” e ndare në Lote: Loti 2: Reagente për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagente për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”. Pra, në rezultim, se dhenia në përdorim e pajisjes/pajisjeve, është një element që nuk është kërkuar nga AK në Dokumentat e Tenderit, çka del jashtë objektit të përcaktuar nga vete AK në Urdhërin e Prokurimit dhe nga vete DST ku përcaktohet si mëposhtë:
Seksioni 2. Objekti i kontrates

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-21512-05-10-2019

Lot 1: REF-21515-05-10-2019

Lot 2: REF-21517-05-10-2019

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

Blerje Qira Leasing Blerje me këste Një kombinim I tyre

X

Përgjegjësitë që u kerkohen Operatoreve ekonomike në Dokumentat e Tenderit janë ato që lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore të tjera të nevojshëm për testimet në Laboratorin Imunologjik sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve të kërkuara prej AK në DST. KVO nuk mund të pranojë ofrimin e pajisjeve në përdorim nga OE FEDOS shpk, si kusht për furnizimin e mallrave

te kerkuar nga AK pasi kjo eshte nje pergjegjesie papercaktuar ne dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka te tille ka shkelur nenin 51/2 te LPP qe percakton: "Nje ofertuesi si kusht per shpalljen fitues, nuk duhet ti kerkohet qe te ndermarre pergjegjesi te papercaktuara ne dokumentat e tenderit, te ndryshoje vleren e ofertes se tij ose te modifikojte ne cfaredolloj menyre oferten. Nese AK do te kishte parashikuar edhe pranimin e dhenies ne perdorim te aparatures, Dokumentat e Tenderit do te ishin ndertuar si ne procedure me nr. REF-99599-12-17-2018, me objekt "Furnizim me Materiale Mjekesore ne Sherbimin e Hemodializes ne QSUT per vitin 2019-2021", ku jo vetem eshte percaktuar ne menyre specifike kerkesa per dhenien ne perdorim te aparaturave por jane percaktuar edhe kerkesat dhe specifikimet teknik ne lidhje me to. Autoriteti kontraktor ka percaktuar si objekt prokurimi thjesht blerjen e reagenteve, si edhe ka percaktuar ne dokumentat e tenderit vetem pajisjet qe ajo ka aktualisht ne perdorim dhe per te cilat duhet te blihen reagent, pra ne asnje moment nuk ka percaktuar ne dokumentat e tenderit se, pajisjet qe ka aktualisht ne perdorim nuk do te perdoren me dhe qe te gjithe operatoret ekonomike pjesemarmes duhet te ofrojne reagentet se bashku me pajisjet e tyre qe pershtaten me keto reagent.

Pika Nr.2

Ne Dokumentat e tenderit, pika 2. 14 te DST, nga AK eshte percaktuar qarte qe nuk do te pranohen variantet

2.14 Do te pranohen variante

Po Jo X

OE FEDOS shpk duke ofruar mallrat e kerkuara te shoqeruara me kushtin e dhenies ne perdorim te pajisjeve te ndryshme nga ato qe disponon AK, te pakerkuara nga AK, gjendet ne kushtet e ofertes alternative e cila sipas kushteve te Dokumentave te Tenderit nuk lejohet. Neni 54 i LPP percakton qe ofertat alternative nuk lejohen, nese nuk jane autorizuar nga AK sic eshte rasti konkret. Nga ana tjeter, eshte vete autoriteti kontraktor ai qe ka percaktuar ne dokumentat e tenderit qe nuk do te pranohen variante, kur nderkohe kualifikon oferten e nje operatori ekonomik i cili oferton me produkte te pajisjeve te tjera ne kundershtrim te specifikimeve teknik te hartuara dhe percaktuara ne dokumentat e tenderit, madje duke lejuar edhe ofertimin e pajisjeve per keto reagente, nderkohe qe objekti i prokurimit eshte vetem blerja e reagenteve. Autoriteti kontraktor nuk mund te lejoje marrjen ne perdorim te nje pajisje tjeter nga ajo qe vete autoriteti kontraktor disponon, ne kundershtrim me percaktimet e tenderit ku ka percaktuar vetem blerjen e mallit, e per me teper qe nje gje e tille nuk eshte percaktuar dhe nuk eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit. Pranimi i marrjes ne perdorim i pajisjeve, referuar si udhezimeve te Ministrise se Shendetesise ashtu edhe legjislacionit per prokurimin publik, duhet te behet nepermjet procedurave te prokurimit sipas percaktimeve te bera ne kete legjislacion. Kualifikimi i operatori ekonomik FEDOS shpk, oferta e te cilit perfshin ofrimin e reagenteve dhe aksesoreve se bashku me pajisjet per keto reagente, ne kushtet kur objekti i prokurimit eshte blerje malla, vjen ne kundershtrim me percaktimet e bera ne dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe shkakton diskriminim dhe konkurrence te pandershme per operatoret e tjere ekonomike pjesemarmes.

Për më teper, percaktimi i termit "ose ekuivalent" ne Specifikimet Teknike i referohet mallrave te kerkuara ne rastet kur ato mund te ofrohen nga prodhues te ndryshem nga prodhuesit e paisjeve, por gjithmone me kusht qe produktet e tyre (i) te perputhen me kerkesat e autoriteit kontraktor, (ii) te permbushin te gjithe specifikimet teknike dhe (iii) te jene funksionale per nevojat e AK. Ne

rastin konkret produktet e ofruara nga OE FEDOS shpk nuk i permbushin keto kushte, sic argumentohet edhe ne piken vijuese Nr.3”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, pika I.2.2 “Njoftimi i kontratës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

| | | | | |
|--------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| Blerje | Qira | Leasing | Blerje me këste | Një kombinim i tyre |
| X | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, pika I.2.12 “Njoftimi i kontratës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

(Objekti dhe fondi limit i LOTEVE)

Loti 1: Reagentë për Imunologjinë e Përgjithshme dhe Pajtueshmërinë Indore (Transplante)

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave te Lotit 1 : eshte 5 021 254.06 (pese milion e njezet e nje mije e dyqind e pesedhjetë e kater pike gjashtë) leke pa TVSH dhe 6 025 504.87 (gjashtë milion e njezet e pese mije e pesëqind e kater pike tetëdhjetë e shtate) leke me TVSH.

Shumatorja e cmimeve per njesi per Lotin 1: 535 836.88 (kater milion e dyqind shtatedhjetë e kater mije e gjashtëqind) lekë pa TVSH dhe 643 004.26 (pese milion e njeqind e njezet e nenete mije e peseqind e njezet) lekë me TVSH

Loti 2: Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatin (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave te Lotit 2: eshte 15 085 710.47 (pesëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë e pese mije e shtatëqind e dhjetë pike dyzet e shtate) leke pa TVSH dhe 18 102 852.56 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e dy mije e tetëqind e pesëdhjetë e dy pike pesëdhjetë e gjashtë) leke me TVSH

Shumatorja e cmimeve per njesi per Lotin 2: 3 120 080.19 (tre milion e njeqind e njezet mije e tetëdhjetë pike nentëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 3 744 096.23 (tre milion e shtatëqind e dyzet e kater nentëdhjetë gjashtë pike njezet e tre) lekë me TVSH

Ndërsa në pikën 2.14 është përcaktuar:

Do të pranohen variantet:

| | | | |
|----|--------------------------|----|---|
| Po | <input type="checkbox"/> | Jo | X |
|----|--------------------------|----|---|

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 “Specifikimet teknike”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PERGJITHSHME

- Afati i skadencës për kitet dhe reagentët: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë konform specifikimeve teknike të veçanta të deklaruara pas çdo Loti.
- Afati i skadencës për materialet konsumabile si dhe lotet që nuk kanë specifikime teknike të veçanta: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

- Kërkohej autodeklaratë për materialet mjekësore, kite, reagentë, konsumablet nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98/79/EC ose 2015/1535/EU, dhe ISO 9001, ose EN ISO 13485, bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë Konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, dhe/ose origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.
- **Autorizim nga MAH / prodhuesi ose Distributori i Autorizuar .**
- Katalogje origjinale ose të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe për të gjithë artikujt dhe të markohen artikujt që ofrohen.
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE VECANTA : LOTI 1

- Reagentët duhet të kenë skadencë ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por jo më të vogël se 6 muaj në ditën e lëvrimit të mallit.
- Duhet të respektohet paketimi dhe sasia e kërkuar.
- Kitet dhe reagentët duhet të jenë kompatibël me aparataturat.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE VECANTA: LOTI 2

- Reagentët duhet të kenë skadencë ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës por jo më të vogël se 6 muaj në ditën e lëvrimit të mallit.
- Duhet të respektohet paketimi dhe sasia e kërkuar.
- Kitet dhe reagentët duhet të jenë kompatibël me aparataturat.

III.1.4. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

Loti 2 Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent

| Nr | Emertimi | Perberja e Reagentit/Kitit | Metoda | Njesia | Sasia |
|----|--|----------------------------|-------------|--------|-------|
| | REAGENTE PER PROTEINAT IMUNOLOGJIKE SERIKE ME LAZERIMUNONEFELOMETER | | | | |
| 1 | Antistreptolysin O (ASO) QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM | 300 TESTE/KIT | NEFELOMETRI | Kit | 7 |
| 2 | C3 complement (C3) QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM | 300 TESTE/KIT | NEFELOMETRI | Kit | 7 |

| | | | | | |
|----|--|-------------------------|--------------------|-------------|-------|
| 3 | <i>C4 complement (C4)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 7 |
| 4 | <i>C-Reactive Protein (CRP)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 35 |
| 5 | <i>Immunoglobulina A (IGA)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 7 |
| 6 | <i>Immunoglobulina G (IGG)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 7 |
| 7 | <i>Immunoglobulina M (IGM)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 7 |
| 8 | <i>Kappa light chain (KAP)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 150 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 5 |
| 9 | <i>Lambda light chain(LAM)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 150 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 5 |
| 10 | <i>Rheumatoid factor (RF)</i> <i>QUANTITATIVE DETERMINATION/SERUM</i> | 300 <i>TESTE/KIT</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>Kit</i> | 7 |
| 11 | <i>Calibrator 1 FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 1 |
| 12 | <i>Calibrator 5 FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 1 |
| 13 | <i>Bufer 1 (BUF1) FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 12 |
| 14 | <i>Bufer 2 (BUF2) FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 1 |
| 15 | <i>Bufer 3 (BUF3) FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 10 |
| 16 | <i>Diluent 1(DIL 1) FOR</i> <i>NEFELOMETRY</i> | <i>vial</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 15 |
| 17 | <i>Ëash Solution (ËASHING SOL)</i> | <i>1 pack 10 L</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 35 |
| 18 | <i>Kyveta Larje (ËASHING CUVETTES)</i> | <i>1 pack</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 2 |
| 19 | <i>KYVETA PER KAMPIONET E SERUMIT (CUP SAMPLES)</i> | <i>cope</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 12000 |
| 20 | <i>Serology Control</i> | <i>1 pack</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>cope</i> | 1 |

| | | | | | |
|----|--|-------------------------------|---------------------------|-------------|-----------|
| 21 | <i>Control Proteins / Proteinat e kontrollit</i> | <i>1 pack</i> | <i>NEFELOMETRI</i> | <i>kuti</i> | <i>1</i> |
| | <i>REAGENTE PER IMUNOFENOTIPIZIM LEUKOCITAR ME FLOW CYTOMETRY</i> | | | | |
| 22 | <i>RI CD45FITC/4-RD1/8-ECD/3-PC5</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>16</i> |
| 23 | <i>RI CD45FITC/56-RD1/19-ECD/3-PC5</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>16</i> |
| 24 | <i>ANTI-CD45 FITC</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>12</i> |
| 25 | <i>ANTI-HLA-DR ECD</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>3</i> |
| 26 | <i>ANTI-CD14 ECD</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 27 | <i>ANTI-CD38 PC5</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>2</i> |
| 28 | <i>ANTI-çD79a PC5</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 29 | <i>ANTI-KAPPA PE</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 30 | <i>ANTI-LAMBDA PE</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 31 | <i>HLA-B27 FITC/B7 PE</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>2</i> |
| 32 | <i>INTRAPREP PERMEABILIZATION / Solucion permeabilizimi intraqelizor</i> | <i>1 PACK (150 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 33 | <i>Solucion OPTILYSE C / ose ekuivalent</i> | <i>1 PACK (200 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>15</i> |
| 34 | <i>ISOFLOW / Solucion izotonik</i> | <i>1 PACK (1 X 10 L)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>20</i> |
| 35 | <i>CLENZ CLEANING AGENT ose ekuivalent / Solucion pastrues</i> | <i>1 PACK (1 X IL)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>2</i> |
| 36 | <i>ANTI-CD5 PE</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>2</i> |
| 37 | <i>ANTI-CD7 PE</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>1</i> |
| 38 | <i>ANTI-CD10 PC5</i> | <i>1 PACK (100 TESTE)</i> | <i>FLOW CYTOMETRY</i> | <i>cope</i> | <i>3</i> |

| | | | | | |
|----|----------------|--------------------|----------------|------|---|
| 39 | ANTI-CD13 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 2 |
| 40 | ANTI-CD19 ECD | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 41 | ANTI-CD20 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |
| 42 | ANTI-CD23 ECD | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |
| 43 | ANTI-CD33 PC5 | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 2 |
| 44 | ANTI-CD34 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |
| 45 | ANTI-CD34 ECD | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |
| 46 | ANTI-CD117 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 2 |
| 47 | ANTI-CD117 PC5 | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |
| 48 | ANTI-cMPO PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 49 | ANTI-CD25 | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 50 | ANTI-CD16 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 51 | ANTI-IGG FITC | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 52 | ANTI-CD19 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 53 | ANTI-CD3 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 54 | ANTI-CD64 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 55 | ANTI-CD55 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 56 | ANTI-CD59 FITC | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 57 | ANTI-FMC7 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 58 | ANTI-TdT FITC | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 59 | ANTI-CD 138 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 2 |

| | | | | | |
|----|---|--------------------|----------------|------|----|
| 60 | ANTI-CD2 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 61 | ANTI-CD4 PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 5 |
| 62 | ANTI-CD 11c PE | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 63 | ANTI-CD 103 Fitc | 1 PACK (100 TESTE) | FLOW CYTOMETRY | cope | 1 |
| 64 | Solucion lizues HUMA-COUNT ose ekuivalent | 1 PACK (1 L) | CELL-COUNTER | Pako | 2 |
| 65 | Solucion CLEANER HUMA-COUNT ose ekuivalent | 1 PACK (1 L) | CELL-COUNTER | Pako | 2 |
| 66 | Solucion Diluent HUMA-COUNT ose ekuivalent | 1 PACK (10 L) | CELL-COUNTER | Pako | 2 |
| 67 | Sample tubes 12*75 mm FOR FLOW CYTOMETRY | 1 PACK (250 TUBES) | FLOW CYTOMETRY | cope | 25 |
| 68 | Sample tubes 14 ml (sterile) konik me tape (vide) | 1 PACK (25 TUBES) | FLOW CYTOMETRY | cope | 5 |
| 69 | Sample tubes 40 ml (sterile) konik me tape (vide) | 1 PACK (25 TUBES) | FLOW CYTOMETRY | cope | 5 |
| 70 | Solucion Ficoll / ose ekuivalent me Densitet 1077 per ndarjen e limfociteve | 100 ml | FLOW CYTOMETRY | cope | 3 |

PS : Per te gjithë zerat e preventivit te cilet nuk kane nje emertim te përshtatur ne shqip por vetem ne anglisht OE te interesuar do ti referohen emertimit ne anglisht per arsye se nuk eshte e mundur përshtatja ne shqip e emertimit te sakte nga gjuha angleze pasi sjell si pasoje keqkuptim dhe konfuzion mbi llojin e materialit apo artikullit qe kërkohet ne te vertete nga AK

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga data e lidhjes se Marreveshjes Kuader me OE shpallur fitues për sejcilin lot.

15% e mallit për secilin material, kit, reagent, konsumabël duhet të lëvrohet maksimumi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër sipas kërkesave të Shërbimit të Laboratorit Immunologjik dhe Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik.

III.1.5. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
 - a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.6. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr. 964, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.1.7. Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

III.1.8. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.1.9. Në nenin 27, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

2.Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrit të mallrave.

3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6.Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit

kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.11. Operatori ekonomik ankimues pretendon se: “Objekti i kësaj procedure prokurimi është: “Blerje materiale mjekesore për shërbimin e Laboratorit Imunologjik në QSUT për vitin 2019-2020” e ndare në Lote. Loti II “Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatin (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”.

Pra qëllimi i kësaj procedure është të prokurojë Materiale Mjekesore (Reagente) për pajisjet në pronësi të autoritetit kontraktor QSUT “Nënë Tereza” LAZER IMUNONEFELOMETRI Model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY Model EPICS – XL të prodhuesit Beckman Coulter. Nga informacioni i tregut që ne disponojmë, operatori ekonomik Fedos sh.p. bashkepunon me kompaninë Becton Dickinson e cila nuk ofron reagente që përputhen me funksionimin e pajisjeve të instaluar në Laboratorin Imunologjik të QSU “Nënë Tereza” të cilave ju referohet kjo procedure prokurimi.

Ne kundërshtim me Nenin 53, Pika 3 të LPP, Autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertën e OE FEDOS shpk të vlefshme nderkohe që reagentet e prodhuesit Becton Dickinson të ofruar nga FEDOS shpk nuk funksionojnë me pajisjet e përcaktuara në objektin e kësaj procedure për të cilat është kërkuar furnizimi me material.

Nga informacioni që disponojmë, FEDOS shpk, duke mos përmbushur kërkesën e përputhshmerisë së reagentëve të ofruar me pajisjet objekt i kësaj procedure ka ofruar pajisje në mënyrë që të funksionojnë reagentet e prodhuar nga Becton Dickinson. Nderkohe, në Dokumentat Standarde të Tenderit nuk përmendet që kerkohen apo që mund të ofrohen pajisje alternative për të realizuar matjen e parametrave të kërkuar, por kerkohen të ofrohen reagent të cilët duhet të funksionojnë me aparataturat ekzistuese të spitalit sipas specifikimeve të përcaktuara në Shtojcën Nr.10 dhe në Shtojcën Nr.12.

OE FEDOS shpk ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK me kushtin e dhenies në përdorim prej tyre të pajisjes/pajisjeve të ndryshme nga prodhuesi Becton Dickinson. Njoftimi i Kontrates dhe

Dokumentat e Tenderit (DT), qe hartohen bazuar ne Urdherin e Prokurimit perkates, kane percakuar qe objekti i kontrates eshte "Blerje materiale mjekesore per sherbimin e Laboratorit Immunologjik ne QSUT per viti 2019-2020" e ndare ne Lote: Loti 2: Reagente per LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE te pershtatshem per aparatn Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagente per FLOW CYTOMETRY te pershtatshem per aparatn (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent". Pra, na rezulton, se dhenia ne perdorim e pajisjes/pajisjeve, eshte nje element qe nuk eshte kerkuar nga AK ne Dokumentat e Tenderit, cka del jashte objektit te percaktuar nga vete AK ne Urdherin e Prokurimit dhe nga vete DST ku percaktohet si meposhte:

Seksioni 2. Objekti i kontrates

2.1 Numri i references se procedures/lotit: REF-21512-05-10-2019

Lot 1: REF-21515-05-10-2019

Lot 2: REF-21517-05-10-2019

2.2 Lloji i "Kontratave Publike per Mallra"

Blerje Qira Leasing Blerje me keste Nje kombinim I tyre

X

Pergjegjesite qe u kerkohen Operatoreve ekonomike ne Dokumentat e Tenderit jane ato qe lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne Laboratorin Immunologjik sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve te kerkuara prej AK na DST. KVO nuk mund te pranoje ofrimin e pajisjeve ne perdorim nga OE FEDOS shpk, si kusht per furnizimin e mallrave te kerkuar nga AK pasi kjo eshte nje pergjegjesie papercaktuar ne dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka te tille ka shkelur nenin 51/2 te LPP qe percakton: "Nje ofertuesi si kusht per shpalljen fitues, nuk duhet ti kerkohet qe te ndermarre pergjegjesi te papercaktuara ne dokumentat e tenderit, te ndryshoje vleren e ofertes se tij ose te modifikoje ne cfaredolloj menyre oferten. Nese AK do te kishte parashikuar edhe pranimin e dhenies ne perdorim te aparatures, Dokumentat e Tenderit do te ishin ndertuar si ne procedure me nr. REF-99599-12-17-2018, me objekt "Furnizim me Materiale Mjekesore ne Sherbimin e Hemodializes ne QSUT per vitin 2019-2021", ku jo vetem eshte percaktuar ne menyre specifike kerkesa per dhenien ne perdorim te aparaturave por jane percaktuar edhe kerkesat dhe specifikimet teknik ne lidhje me to. Autoriteti kontraktor ka percaktuar si objekt prokurimi thjesht blerjen e reagenteve, si edhe ka percaktuar ne dokumentat e tenderit vetem pajisjet qe ajo ka aktualisht ne perdorim dhe per te cilat duhet te blihen reagent, pra ne asnje moment nuk ka percaktuar ne dokumentat e tenderit se, pajisjet qe ka aktualisht ne perdorim nuk do te perdoren me dhe qe te gjithe operoret ekonomike pjesemarmes duhet te ofrojne reagentet se bashku me pajisjet e tyre qe pershtaten me keto reagent.

Pika Nr.2

Ne Dokumentat e tenderit, pika 2. 14 te DST, nga AK eshte percaktuar qarte qe nuk do te pranohen variantet

2.14 Do te pranohen variante

Po Jo X

OE FEDOS shpk duke ofruar mallrat e kerkuara te shoqeruara me kushtin e dhenies ne perdorim te pajisjeve te ndryshme nga ato qe disponon AK, te pakerkuara nga AK, gjendet ne kushtet e ofertes alternative e cila sipas kushteve te Dokumentave te Tenderit nuk lejohet. Neni 54 i LPP percakton qe ofertat alternative nuk lejohen, nese nuk jane autorizuar nga AK sic eshte rasti konkret. Nga ana tjeter, eshte vete autoriteti kontraktor ai qe ka percaktuar ne dokumentat e

tenderit që nuk do të pranohen variante, kur nderkohe kualifikon ofertën e një operatori ekonomik i cili oferton me produkte të pajisjeve të tjera në kundërshtim të specifikimeve teknik të hartuara dhe përcaktuara në dokumentat e tenderit, madje duke lejuar edhe ofertimin e pajisjeve për keto reagente, nderkohe që objekti i prokurimit është vetëm blerja e reagenteve. Autoriteti kontraktor nuk mund të lejojë marrjen në përdorim të një pajisje tjetër nga ajo që vete autoriteti kontraktor disponon, në kundërshtim me përcaktimet e tenderit ku ka përcaktuar vetëm blerjen e mallit, e për më tepër që një gjë e tillë nuk është përcaktuar dhe nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit. Pranimi i marrjes në përdorim i pajisjeve, referuar si udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ashtu edhe legjislacionit për prokurimin publik, duhet të behet nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të bëra në këto legjislacion. Kualifikimi i operatori ekonomik FEDOS shpk, oferta e të cilit përfshin ofrimin e reagenteve dhe aksesoreve së bashku me pajisjet për keto reagente, në kushtet kur objekti i prokurimit është blerje malli, vjen në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe shkakton diskriminim dhe konkurrencë të pandershme për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës.

Për më tepër, përcaktimi i termit "ose ekuivalent" në Specifikimet Teknike i referohet mallrave të kërkuara në rastet kur ato mund të ofrohen nga prodhues të ndryshëm nga prodhuesit e paisjeve, por gjithmone me kusht që produktet e tyre (i) të përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, (ii) të përmbushin të gjithë specifikimet teknike dhe (iii) të jenë funksionale për nevojat e AK. Në rastin konkret produktet e ofruara nga OE FEDOS shpk nuk i përmbushin keto kushte, sic argumentohet edhe në piken vijuese Nr.3.

III.1.12. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: Në lidhje me kërkesat e subjektit ankues, Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankës (KSHA), referuar dhe specializimeve perkatese, argumentojnë si më poshtë vijon:

Vlerësimi dhe gjykimi i KSHA:

Për sa i përket pretendimeve të OE ankimues, KSHA në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, si dhe VKM 914/2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, KSHA vlerëson se:

Në lidhje me piken 1 dhe piken 2 me sipër:

Se pari, KSHA vlerëson, se nga verifikimi i dokumentacionit tekniko- ligjor të venë në dispozicion, KVO ka vlerësuar OE ofertues, konkretisht edhe për OE Fedos shpk, mbi bazën e mallrave të ofertuar (materiale mjekësore- reagente), referuar Formularit të Ofertes sipas Shtojcës 1 si dhe të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në SPE, në krahasim me kërkesat e bëra në DST nga AK, dhe në rastin e OE Fedos, KVO nuk ka vlerësuar ofertën ekonomikë duke u bazuar në ofrimin e aparaturave falas, por vlerësimi i ofertes ekonomikë rezultoi të jetë bërë mbi bazën e përmbushjeve të kriterëve të kërkuara në DST në lidhje me specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen etj.

Për sa i përket situatës që OE ankues shtron, vlen të sqarohet se nisur që nga titulli i procedurës së prokurimit, që është: Blerje materiale mjekësore për shërbimin e Laboratorit munologjik në QSUT për vitin 2019-2020 " e ndare në Lote si më poshtë: Loti 1, Reagente për munologjinë e Përgjithshme dhe Pajtuëshmerinë Indore (Transplante) dhe Lot 2, Reagente për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter e ekuivalent dhe reagente për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent, rezultoi se AK nëpërmjet kontratës publike të shpallur në SPE, të ndare

ne dy lote, synon blerjen e materialeve mjekesore (reagente), fakt ky qe edhe vete OE ankues e citon si vijon: ...qellim i kesaj procedure eshte te prokuroje material mjekesore (reagente) per pajisjet ne pronesi te AK...[.]...LAZER IMUNONEFELOMETRI model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY model EPICS-XL.

Per sa i perket ceshtjes ne teresi qe shtron OE ankues ne pike 1 dhe 2, ne lidhje me aparatet ne pronesi te AK, rezulton se titulli i kontrates ne teresi per Lotin 2 eshte: Reagente per LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE te pershtatshem ner aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagente per FLOW CYTOMETRY te pershtatshem per aparatin (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”, dhe jo sic citohet nga OE ne ankim, ku citohet: REAGENTE per LAZER IMUNONEFELOMETRI model IMAGE dhe FLOW CYTOMETRY model EPICS-XL. Pra se pari vlen te theksojme se objekti i prokurimit eshte blerje reagente (materiale mjekesore), dhe jo materiale mjekesore posacerisht per x apo y aparat, per kete arsye jo me kot AK referon ne titullin e kontrates se shpallur: te pershtatshem per aparatin Beckman Coulter ose ekuivalent dhe te pershtatshem per aparatin (EPICS-XL) te Beckman Coulter ose ekuivalent. Ne kete konstekt, qe ne kete pike, del qarte se AK kerkon te prokuroje mall (materiale mjekesore-reagente), i cili duhet se pari te plotesoje specifikimet teknike te pasqyruara ne DST, dhe i cili te jete i pershtatshem per aparatin qe AK disponon ose te jete i pershtatshem per nje aparat tjeter ekuivalent dhe te cilin nese AK e disponon apo jo nuk eshte objekt vleresimi apo ankimi nga operatoret ekonomik ofertues. Me tej, referuar dispozitave ligjore ne fuqi te parashikuara Legjislacionin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, eshte vete AK qe percakton mallrat me te cilet synon te furnizohet nepemjet prokurimit, specifikimet teknik qe duhet te permbushin keto mallra, si dhe harton kriteret e nevojshme qe nje ofertues i mundshem duhet te plotesoje qe te kualifikohet si ofertues ne proceduren e prokurimit te cilen vete AK e shpall sipas procedurave ligjore ne fuqi, nepermjet Dokumenteve Standarde te Tenderit te hartuara dhe miratuara nga APP sipas parashikimit te nenit 13, germa ç) ku citohet se: APP.. harton dokumentet standarde te tenderit, qe do te perdoren ne procedurat e prokurimit, sipas rregullave te prokurimit public; Referuar Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, ne nenin 23 (Specifikimet teknik) Legjislatori sanksionon se: 1.Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristika e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithë kandidatëve e ofertuesve. [..] dhe 2 .

Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te njejte per te gjithë kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos shërbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin public. Kete qendrim ne lidhje me perdorimin e termit ekuivalent, mban edhe vete Agjencia e Prokurimit Publik ne Rekomandimin Nr 3341 / 1 prot , date 20 . 03 . 2018 " Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik", drejtuar Autoriteteve Kontraktore, dhe ne kete kuader, si dhe ne zbatim te frymes se legjislacionit që rregullon fushen e prokurimit publik jemi para parimit Argumentum ab auctoritate fortissimum est in lege - pra para parimit se nje argument I shkruar nga autoriteti me i larte qe eshte APP, ka fuqine e ligjit per te gjithë aktoret si ne cilesine e AK ashtu dhe ne cilesine e OE. Dhe per aq kohe se ne kontraten e shpallur kerkohen materiale mjekesore te pershtatshem per nje aparat X ose ekuivalent, KSHA vlereson se AK ka cdo te drejte te mundshme te kualifikoje nje operator ekonomik ofertues, ne rastin kur mallrat e ofruar plotesojne specifikimet teknik te kerkuara ne DST, si dhe OE ofertues

permbush te gjitha kriteret kualifikuese te hartuara sipas nenit 46 te LPP te cilat percaktohen nga AK ne DST dhe qe AK i vlereson sipas percaktimeve te nenit 53, pika 3, 4, 5/c, te Ligiit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, te VKM Nr 914, date 29.12.2014 per "Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar.

Së dyti, e gjitha gama e ankimit eshte e ndertuar dhe referohet vetem mbi bazen e informacionit qe OE Ankues "Montal" Shpk, pretendon se disponon , por ne asnje rast, ankimit nuk i bashkelidhet dokumentacion teknik e ligjor qe te vertetoje ato që ankuesi referon, apo te ndihmoje AK ne thellimin e hetimit aministrativ për të dhënë një përgjigje bazuar ne parimin stricti iuris, pasi referuar dokumentacionit te vene ne dispozicion nga Njesia e Prokurimit, rezulton se mallrat e ofruar nga OE Fedos Shpk, i permbushin specifikimet teknik te kerkuara nga AK. Referuar legjislacionit ne fuqi, qofte ne kete rast, si dhe ne rastin që OE Montal Shpk, apo cdo OE tjeter ushtron pretendime per nje operator tjeter ekonomik, ne ankesen e paraqitur, ka detyrimin ligjor per te argumentuar pretendimet e ngritura, ne kuptimin klasik te barres se proves (kur barra e proves i bie kerkuesit) dhe ne rastin objekt shqyrtimi, OE Montal shpk, ne asnje rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe me pas provuar me dokumente shtese (por vetem referuar dhe mbi bazen e pretendimeve) faktin e mosplotesimit te specifikimeve teknik nga OE Fedos Shpk. Kete argumentim KSHA e mbeshet ne dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise, neni 12 ku citohet se: "Pala qe pretendon nje te drejte, ka detyrim qe, ne perputhje me ligjin, te provoje faktet mbi te cilet bazon pjetendimin e saj", nenit 1 [...]; Nenit 47 [...]; Nenit 78/1 [...] dhe nenit 82 pika 1 [...].

Se treti, nga verifikimi i dokumentacionit te administruar, KSHA vlereson se ne asnje moment ofrimi i aparateve falas nga OE ofertues, nuk parashikohet si kusht ne DST. Nga verifikimi i procesverbalit te mbajtur nga KVO dhe raportit te gjeneruar nga SPE, gjithashtu rezulton se ne asnje moment ofrimi i aparateve falas nuk ka sherbyer si kush per KVO qe te vleresoje nje oferte si te vlefshme apo jo, pasi vleresimi i vlefshmerise se ofertes nga KVO eshte bere duke u bazuar ne permbushjen e specifikimeve teknik te mallrave te ofertuar si dhe ne permbushjen e kriterëve kualifikuese te pasqyruara ne DST. Pra rezulton se KVO ne vleresim Eshte bazuar ne faktin se te dy OE ofertues ne kete procedure prokurimi, plotesojne kriteret e kualifikimit te kerkuara nga AK ne DST, dhe per kete arsye KVO ka vleresuar dhe me pas kualifikuar te dy OE ofertues, duke bere me pas dhe renditjen perkatese bazuar ne kriterin cmimi me i ulet sipas percaktimeve te DST, ne te njejten kohe duke mosdiskriminuar asnje OE ofertues.

Per sa i perket pikes 3 me siper, referuar ankeses se OE Montal Shpk, KSHA vlereson se:

Materialet mjekesore te ofruar nga OE Fedos Shpk, permbushin specifikimet teknik te kerkuara ne DST, kjo jo vetem nga dokumentacioni i administruar ne SPE, por edhe nga dokumentacioni tekniko-ligjor shkresor qe administrohet nga AK, pasi referuar korrespondences se KVO ne zbatim te procedurave ligjore, rezulton se jo vetem qe OE ofertues permbush specifikimet teknike te kerkuara ne DST nga AK, por gjithashtu rezulton se malli i ofruar rezulton me perfitime qofte ne cilesi, qofte ne perfitime ekonomike per AK, duke permbushur ne te njejten kohe kushtet ligjore per te zbatuar kontraten e shpallur. Kjo referuar edhe korrespondences me Sherbimin e Imunologjise dhe Pajtueshmerise Indore prana AK QSU "Nene Tereza", i cili ben me dije Komisionin e Vleresimit te Ofertave per pyetjet e shtruara dhe pergjigjet sa me poshte:

Pyetjet e KVO:

4. Lutem te na sqaroni dhe informoni mbi pajisjet qe paragiten nga ky ofertues, ne se Sherbimi I Laboratorit Immunologjik eshte i njohur me keto pajisje, eshte ne gjendje te perdore teknologjine e ofruar bazuar ne metodat e tuaja te ofrimit te sherbimit.
5. Gjithashtu na informoni nese ofrimi nga ky OE i ketyre pajisjeve ka impakt negativ apo pozitiv prane Sherbimit krahasuar me pajisjet ekzistuese qe ndodhen prane Sherbimit dhe nese ka ndikim ne rritjen e performances prane Sherbimit etj.
6. Per sa i perket mallit te ofertuar, lutemi te na sqaroni nese perben problematike apo pengese per sherbimin, paketimi i produkteve duke u ndodhur para faktit qe sasia ne total nuk ndryshon per mallin e kerkuar per Lot I dhe Lot 2 sipas DST bashkelidhur.

Pergjigja e Sherbimeve prana AK:

Teknologjia e Citometrit me fluks BD FACS Canto II te kompanise Beckton-Dickinson:

BD FACS Canto II eshte nje gjenerate e re ne fushen e citometrise me fluks. Kjo pajisje eshte e projektuar per perdorim si ne labororet klinike ashtu dhe hulumtues. Eshte nder teknologjite me te perdorura ne Europe dhe me gjere. Kjo teknologji ka performace te larte, sakesi dhe cilesi ne dhenien e rezultateve. FACS Canto II ka disa perparesi krahasuar me EPICS-XL te Beckman Coulter qe eshte ne perdorim aktualisht:

- *Eshte teknologji 15 vite me e re*
- *Eshte e pajisur me tre lazera krahasuar me ate qe disponojme aktualisht qe ka nje lazer.*
- *Detekton 8 ngjyra krahas 4 ngjyra qe detekton ajo aktuale.*
- *Softëare eshte shume me i avancuar pasi jep shume te dhena njekohesisht mbi popullatat qelizore, ruan per nje kohe te gjate te dhenat, i perpunon ato dhe i printon njekohesisht. Nderkohe që EPICS-XL aktual që disponojme ka mangesi, si ne ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave dhe printimin automatik te tyre.*
- *Marrja e mostrave ne menyre automatike ben qe te rritet shpejtesia e perfitimit te te dhenave.*

Imunonefelometri SPA PLUS te kompanise angleze Binding Site:

Ky autoanalizator eshte prodhim i kompanise angleze Binding Site, e njohur ne kete fushe. Eshte nje autoanalizator qe eshte projektuar enkas per matjen e proteinave serike. Ka nje sistem plotesisht automatik qe ofron rezultate te cilesise se larte. Rezultati i pare del ne 15 min dhe ato pasardhese pas cdo 30 sek. Realizon 240 ekzaminime per nje ore. Siguron perdorim optimal te reagentit pasi jane ne paketime me numer me te vogel testesh. Eshte teknologji me e avancuar pasi eshte 15 vjet me e re si gjenerate pajisjesh te ketij lloji.

Dhe në këte kuader, KSHA vlereson se KVO ka vleresuar drejtë dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi persa I perket kualifikimit te OE Fedos sh.p.k., dhe per pasoje pretendimi I ngritur nga OE Montal shpk, nuk qendron.

Ne kete kuader, per sa eshte argumentuar me siper, si dhe ne kuader te frymes se transparences te cilen legjislatori e synon nepermjet legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, KSHA ne respektim te detyrimeve qe burojne nga dispozitat e ligjit nr. 9643 dt 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar si dhe VKM nr 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publike ndryshuar, ka arritur ne, Konkluzionin:

Te mos pranoje pretendimet e ngritura nga OE Montal SHPK, ne ankesen e administruar prane AK QSU "Nene Tereza" me nr. 2411 prot., date 27.06.2019, si e pabazuar ne ligj dhe prova.

III.1.13. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. konstatohet se është paraqitur si më poshtë:

- Shtojca 1, Oferta teknike, ku evidentohet se janë deklaruar produktet, specififikimet teknike të tyre, prodhuesi, origjina, skadenca e mallit, emertimi i katalogut, nr. i faqes në katalog, referenca dhe certifikimi.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. mbi origjinën e produkteve që do të ofrojë, ku për “Nefelometrin” është kompania prodhuese “Binding Site”; për “Flow Cytometry” janë kompanitë prodhuese “BD Biosciences – Pharmingen”, “F1 Medical” dhe “Stemcell Technologies”.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. për përmbushjen e specifikimeve teknike si dhe specififikimet teknike sipas shtojcës 10 të DST.
- Autodeklaratë e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. ku deklarohet se: *“Unë i nënshkruari Z.O.S, e cilësinë e administratorit të personit juridik “Fedos” sh.p.k. deklaroj se: nese do te shpallemi fitues për LOT 2 do të sjellim falas psjisjet në përdorim Nefelometër dhe FlowCytometër. Gjithashtu për LOT 1 dhe LOT 2 pavarësisht paketimeve të ofertuara sasia totale e mallit që do të lëvrohet do të jetë në total e barabartë me sasinë e kërkuar në DST.”*
- Autorizimi i prodhuesit nga kompania Becton Dickinson International për operatorin ekonomik ku përcaktohet se: *“Becton Dickinson International – Dege e Becton, Dickinson B.V (BDI) me anë të kësaj konfirmon dhe vërteton atë Fedos sh.p.k. me adresë lejohet për të paraqitur një ofertë për tenderin e përshkruar më sipër dhe pastaj negociojë dhe nënshkruajë Kontratën me Qendrën Spitalore Universitare “Mother Teresa” Tiranë për reagentë të përdoren për Flow Cytometry (the “Products”) të prodhuara nga BD Biosciences[...]*”
- Autorizimi i prodhuesit nga kompania Stemcell Technologies Inc. ku përcaktohet se: *“Ne Stemcell Technologies Inc., të cilët janë prodhues të mediave të kulturave të qelizave specialiteti, sistemeve të izolimit të qelizave dhe produkteve ndihmëse për hulumtimet e shkencës së jetës, duke pasur fabrika në 1618 Station Street, Suite 500 në Vancouver, V6A 1B6, BC, Canada autorizojnë këtu: Fedos shp.k. ... Të dorëzoni një ofertë, dhe më pas të negocioni dhe të nënshkruani Kontratën me ju për prokurimin për mallrat e prodhuara nga ne [...]*”.
- Autorizimi i prodhuesit nga kompania Binding Site Group Limited, për shoqërinë “Fedos” sh.p.k., për pjesëmarrje në tenderin objekt shqyrtimi.
- Autorizimi i prodhuesit nga kompania FL Medical, për shoqërinë “Fedos” sh.p.k., për pjesëmarrje në tenderin objekt shqyrtimi.
- Katalog “SPA PLUS”, të kompanisë Binding Site
- Katalog “BD FACSCANTO II”, të kompanisë Binding Site

III.1.14. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.15. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një*

ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

III.1.16. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë të interesuar duhet të kryejnë furnizimin me reagent, pra procedura e prokurimit është blerje reagentë, të cilët duhet të jenë kompatibël me pajisjet ekzistuese që janë aktualisht në përdorim nga ana e autoritetit kontraktor, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. në SPE, rezulton se ky i fundit ka paraqitur një “Autodeklaratë” në të cilën deklaron se: *“Unë i nënshkruari Z.O.S, e cilësinë e administratorit të personit juridik “Fedos” sh.p.k. deklaroj se: nese do te shpallemi fitues për LOT 2 do të sjellim falas pajisjet në përdorim Nefelometër dhe FlowCytometër.”* Pra, operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. në mënyrë të shprehur pranon se, së bashku me produktet (reagentët), do të sjellë falas, edhe pajisjet në përdorim për këto reagent, kërkesë kjo e cila nuk është parashikuar në dokumentat e tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor.

Në asnjë moment nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit nuk është përcaktuar se kërkohet kryerja e shërbimit të pajisjeve, së bashku me reagentët, por është përcaktuar vetëm blerja e mallit dhe procedura është publikuar si procedurë blerje. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar si objekt prokurimi thjesht blerjen e reagentëve, si edhe ka përcaktuar në dokumentat e tenderit vetëm pajisjet që ajo ka aktualisht në përdorim dhe për të cilat duhet të blihen reagentët, pra në asnjë moment nuk ka përcaktuar në dokumentat e tenderit se, pajisjet që ka aktualisht në përdorim nuk do të përdoren më dhe që të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofrojnë reagentët së bashku me pajisjet e tyre që përshtaten me këto reagentë.

III.1.17. Në legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe konkretisht Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, përcaktohet se:

“35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumenta autorizues - janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Te tilla janë urdherat e blerjeve, kontratat, urdheri për krijimin e komisioneve, urdher për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentat përmbledhës ose rregjistrat kontabel (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të cdo lloji forme 11, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative¹². Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve”.

37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i cmimit (Procesi i marrjes në dorezim të aktiveve, referuar kushteve të percaktuara në kontrate).

38. Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitetet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme. 40. Magazinieri dorezon tek nepunesi pergjegjes per financat e njesise nga nje kopje origjinale per flete hyrjet, faturen e furnizuesit (shitesit) si dhe flete daljen, si dhe hedh ne 11 Sipas percaktimit ne nenin 4/26 te ligjit 10296 dhe te nenit 3/1 te Ligjit 10 273, datë 29.4.2010 “Per Dokumentin elektronik”. 12 Sipas percaktimit ne Nenin 4/26 te ligjit 10296, date 8.07.2010 “Per MFK” 9 kartelat e magazines levizjet perkatese ne sasi dhe ne vlere sipas afateve te percaktuar nga njesite publike ne funksion te specifikes se aktivitetit te tyre.

41. Në rast të caktuara sipas nevojave të njesise publike, behet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi të përdoruesi (p.sh direkt në njesine shpenzuese të njesise publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (psh. në magazinën qendrore të njesise publike). Në këto rast duhet të miratohen nga Nepunesi Autorizues i njesise publike procedura të qarta të levizjes, të shoqeruara me pergjegjesite respektive. Veprimet behen ne prani te punonjesve te ngarkuar me administrimin e aktiveve”.

Nga ana tjetër, është vetë autoriteti kontraktor ai që ka përcaktuar në dokumentat e tenderit që nuk do të pranohen variantet, kur ndërkohë kualifikon ofertën e një operatori ekonomik i cili oferton me produkte të pajisjeve të tjera në kundërshtim të specifikimeve teknike të hartuara dhe përcaktuara në dokumentat e tenderit, madje duke lejuar edhe ofertimin e pajisjeve për këto reagentë, ndërkohë që objekti i prokurimit është vetëm blerja e reagentëve.

Akoma më tej, referuar informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor, ky i fundit, ka bashkëlidhur komunikimin me institucionin e Shërbimit të Laboratorit Imunologjik, të cilit i është drejtuar me shkresën nr. 1824/3 prot., datë 19.06.2019 (shkresë kjo e përmendur edhe në kthimin e përgjigjes së ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Montal” sh.p.k.), ku i kërkohet informacioni si më poshtë “...për Lotin 2 “Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent”, njëri nga ofertuesit në formë të dokumentuar deklarative, në rast të shpalljes fitues për këtë procedurë prokurimi (Lot 2), deklaroi se ofron falas pajisjen Nefelometër (të llojit: SPAPLUS®) dhe FlowCytometër (të llojit: BD FACSCanto II). [...]

Për këtë arsye dhe sa parashtruam më sipër, duke u ndodhur përpara alternativës ekuivalente të mallit të kërkuar, nevojitet vlerësimi i plotë i dokumentacionit teknik dhe ligjor në përputhje me RrPP dhe LPP si dhe efekteve pozitive dhe negative që ka për AK, për këtë arsye: 1. Lutemi të na sqaroni dhe informoni mbi pajisjet që paraqiten nga ky ofertues [...]. 2. Gjithashtu na informoni nëse ofrimi i këtyre pajisjeve ka impakt negativ apo pozitiv pranë Shërbimit krahasuar me pajisjet ekzistuese [...]”.

Pra, sa më sipër, KPP, konstaton se në shkresën drejtuar Shërbimit të Laboratorit Imunologjik, autoriteti kontraktor, në mënyrë të shprehur pranon se operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. në ofertën e tij ka paraqitur produktet e ofruara së bashku me pajisjet për këto produkte, pra malli i ofruar nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. nuk i shërben pajisjeve ekzistuese të autoritetit kontraktor, por do ofrohen nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. së bashku me pajisjet e tyre.

Autoriteti kontraktor nuk mund të lejojë marrjen në përdorim të një pajisje tjetër nga ajo që vetë autoriteti kontraktor disponon, në kundërshtim me përcaktimet e tenderit ku ka përcaktuar vetëm blerjen e mallit, e për më tepër që një gjë e tillë nuk është përcaktuar dhe nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se, pranimi i marrjes në përdorim i pajisjeve, referuar si udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ashtu edhe legjislacionit për prokurimin publik, duhet të bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të bëra në këtë legjislacion.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kualifikimi i operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k., oferta e të cilit përfshin ofrimin e reagentëve së bashku me pajisjet për këto reagentë, në kushtet kur objekti i prokurimit është blerje mallra, vjen në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe shkakton diskriminim dhe konkurrencë të pandershme për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.18. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.19. Sqarojmë se, në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.1.20. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.21. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e përrjedhë duke përmbushur interes e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-21517-05-10-2019, me objekt Loti II “*Reagentë për LAZER IMUNONEFELOMETRI IMMAGE të përshtatshëm për aparatën Beckman Coulter ose ekuivalent dhe reagentë për FLOW CYTOMETRY të përshtatshëm për aparatën (EPICS-XL) të Beckman Coulter ose ekuivalent*”, me fond limit 15.085.710,47 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Montal” sh.p.k
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1252 Protokolli

Datë 12.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

| | | | |
|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
| Enkeleda Bega | Vilma Zhupaj | Lindita Skeja | Merita Zeqaj |

Kryetar
Evis Shurdha